



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.275/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Kymete Kicaj dhe Ferki Xhaferi anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Adile Kastrati nga Gjermani, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 05.02.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet i pabazuar apeli** i ushtruar nga Adile Kastrati nga Gjermani, me të cilin kërkon që të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës.

## A r s y e t i m

Me datën 03.02.2021 PZAP-i ka pranuar një apel nga Adile Kastrati nga Gjermani, në të cilën pretendohet se shkak i apelit është refuzimi apo mos përmbyshja e kushteve për tu përfshirë në listën e votuesve jashtë Kosovës si dhe mos shpjegimi i arsyes së refuzimit nga KQZ-ja.

Parashtruesi i apelit nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi lidhur me pretendimet në apel.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimet e apelit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

### Apeli është i pabazuar

Paneli, pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se apeli është i pabazuar pasi që parashtruesi i apelit gjatë aplikimit të tij për regjistrim për votim jashtë Kosovës, nuk i ka plotësuar kriteret të cilat kërkohen në bazë nenit 5.1 pika a) të LZP-së ku përcaktohet: *“çdo person ka të drejtë për të votuar nëse është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil të Kosovës”*, si dhe dispozita e nenit 3.1 të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se: *“votuesi me zotësi juridike jashtë Kosovës mund ta hedh fletëvotimin për zgjedhjet në qoftë se është regjistruar si banorë i përhershëm i Kosovës në Regjistrin Qendror civil”*.

Nga shkresat e lëndës Paneli, vlerësoi se parashtruesi i apelit në momentin e aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës dosja e tij nuk ka qenë e kompletuar dhe nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara siç parashihet me dispozitat e nenit 5.1 pika a) të LZP-së dhe të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së dhe nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, 122 par.1 pika a) të LZP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
A nr. 275/2021 më datën 05.02.2021



*Këshillë Juridike:* Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.